



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**Nr.regj. 03-278**  
**19.09.2022**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 20 dhe neni 23 paragrafi 1 alineja 1 nga Ligji për shërbime Mediatike audio dhe Audiovizuele (“Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe “Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë se Veriut” nr. 42/20 dhe 77/21), në lidhje me nenin 5 paragrafi 3 i ligjit të njëjtë, neni 17 nga Rregullorja për mbrojtjen e personave të mitur (“Gazetë zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 172/14), pika 6 nga Udhëzimit për përcaktimin e afateve për veprim ndaj aktvendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa (tekst i spastruar) nr.01-6039/1 nga data 20.10.2015, Raporti i shkruar i mbikëqyrjes programore nr.ark.10-3261/1 nga data 26.08.2022 dhe Konkluzioni nr.ark 02-3436/4 nga data 16.09.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime Mediatike audio dhe Audiovizuele, në mbledhjen e 35-të të mbajtur më datë 16.09.2022, e miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrjen e masës – vërejtje publike**

1. VËREJTJE PUBLIKE ndaj Shoqërisë Tregtare të Radiodifuzionit (SHTR) KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, për shkak të shkeljes së nenit 50 paragrafi 3 nga Ligji për shërbime Mediatike audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe neni 17 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur (RMPM), në mënyrë që në shërbimin e vet programor televiziv më datë 5 gusht 2022, në premierë dhe reprizë të epizodave të emetuara të serialeve: “Fatih Hrbiye” dhe “Benim adim Melek”, si dhe në njoftimet promovuese për emetimin e tyre, ishin klasifikuar në mënyrë joadekuate dhe të shënuara si program i kategorisë së parë, në vend se të jenë të klasifikuara si program i kategorisë së dytë, që nuk rekomandohet për fëmijë nën moshën 8 vjecare, respektivisht për të cilën rekomandohet mbikëqytja e prindit ose kujdestarit.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike, të specifikuar në Raportin e shkruar të mbikëqyrjes së realizuar programore me nr.ark.10-3261/1 nga data 26.08.2022, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si pjesë përbërëse e Aktvendimit si Shtojcë nr.1.

2, OBLIGOHET Shoqëria Tregtare të Radiodifuzionit KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të Aktvendimit, ta përshtasë punën e vet me dispozita të LSHMAA dhe RRPAM,

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar me pikën 2 të këtij Aktvendimi, të bëhet një mbikëqyrje kontrolluese, me qëllim të konstatimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, që është theksuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi,

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, ndërsa si ditë e miratimit të tij konsiderohet dita e vërtetimit të tij në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike audio dhe Audiovizuele (Agjencisë).

**A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 28 nga LSHMAAV është kompetente për mbikëqyrjen programore (monitorim) të programeve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimeve Mediatike Audiovizuele me kërkesë, si dhe të pakove programore që i ritransmetojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave të Ligjit të cituar, lejet, vërtetimet e lëshuara për regjistrim, aktet nënligjore si dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 alineja 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – aktvendim për vërejtje publike në pajtim me Ligjin, në rastet kur është bërë shkelje e dispozitave të LSHMAA dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij, si dhe kushtet dhe obligimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 50 paragrafi 1 nga LSHMAAV, ofruesit e shërbimeve Mediatike Audiovizuele nuk guxojnë që të transmetojnë programe që mundën me seriozitet të dëmtojnë zhvillimin fizik, psikik ose

moral të personave të mitur, veçanërisht programe që përmbajnë pornografi ose dhunë të panevojshme. Ndalesa nga paragrafi (1) të këtij neni kanë të bëjnë edhe me programe të tjera që me gjasë mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, psikik ose moral të personave të mitur, përveç kur sigurohet emetimi dhe reprizimi i tyre në një periudhë të caktuar kohore dhe/ose me zbatimin e masave të caktuara teknike, që të miturit në periudhën e emetimit ose reprizimit nuk do të mund ti dëgjojnë ose shohin programet. Kur këto programe emetohen ose reprizohen në formë të koduar, ofruesi i shërbimeve Mediatike Audiovizuale është i obliguar që para emetimit të tyre të sigurojë paralajmërim akustik paraprak dhe mundësi që të shihen edhe shenja vizuale gjatë kohëzgjatjes së tyre (neni 50 paragrafi 3 nga LSHMAAV).

Në nenin 17 paragrafi 1 pika 2 e Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur e përcakton se në kategorinë e dytë klasifikohen programe që nuk rekomandohen për fëmijë nën moshën 8 vjeçare, për të cilën është e domosdoshme mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit. Mund të përfshihen edhe tema më serioze: sjellja devijuese, dhuna në familje, racizmi, etj., mirëpo në programet në asnjë rast nuk mund të nxiten ose përfshihen afirmime të çfarëdollojshme të sjelljes devijuese ose sjelljeve ofenduese ndaj dinjitetit njerëzor.

Nuk lejohet përdorimi i tepruar i gjuhës së pahijshme (vulgare). Lejohet paraqitja neutrale dhe natyrale e trupit të zhveshur të njeriut, mirëpo pa kurrfarë konteksti vulgar seksual. Përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet erotike patjetër duhet të jenë tejet të rralla dhe pothuajse të padukshme, diskrete dhe pa aludime vulgare. Lejohet emetimi i matur i dhunës, por pa detaje të ashpra, që arsyetohen sipas skenarit, pa u potencuar prania e armëve të vërteta ose teknikave të rresikshme të konfrontimit.

Në kuadër të kompetencave të veta ligjore, Agjencia përmes Sektorit për Cështje Programore, më datë 26 gusht 2022, realizoi një mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, të emetuar më datë 5 gusht 2022, në nivel shtetëror, me c'rast ka konstatuar shkelje të nenit 50 paragrafi 3 i LSHMAAV dhe të nenit 17 të PSHPR.

Me mbikëqytjen e rregullt është konstatuar se më datë 5 gusht 2022, në shërbimin programor televiziv të SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, premirerat dhe reprizat e epizodave të emetuara të serialeve: "Fatih Hrbije" dhe "Benim adim Melek", telenovela të metrazhit të gjatë në disa sezona, si dhe në njoftimet promovuese për emetimin e tyre në shërbimin programor më datë 5 gusht 2022, ishin klasifikuar në mënyrë joadekuate dhe të shënuara si program i kategorisë së parë, të dedikuara për të gjithë publikun.

Duke marrë parasysh përmbajtjen e tyre dhe qasjen e regjisë, si dhe në bazë të faktit se vec më janë emetuar ose emetohen ende në shërbimet programore të radiodifuzerëve të tjerë (me përkthim adekuat të titujve të tyre: - "Zemra e lënduar" dhe "Lufta e nënës") – është adekuate që serialet të klasifikohen dhe shënohen si – program i kategorisë së dytë (8+) që nuk rekomandohet për fëmijë nën moshën 8 vjeçare, për të cilën rekomandohet mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, e specifikuar edhe në Raportin e shkruar për mbikëqyrjen e realizuar programore me nr.ark. 10-3261/1 nga data 26.08.2022 që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si në Shtojcën nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 3 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë dërgoi deri te SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup më datë 29.08.2022, një shkresë me nr. ark.10-3261/2 nga data 29.08.2022, me të cilën e dorëzon Raportin e shkruar për mbikëqyrjen e realizuar programore me nr.ark. 10-3261/1 nga data 26.08.2022, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditëve të punës nga dita e pranimit të shkresës deri te Këshilli i Agjencisë të parashtrojë prononcim në formë të shkruar në lidhje me shkeljen e bërë të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga radiodifuzeri më datë 29.08.2022 në afatin e paraparë, respektivisht më datë 01.09.2022 SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup dorëzoi deri te Agjencia prononcim me shkrim me nr.ark. 10-3261/3 nga data 01.09.2022. Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur më datë 16.09.2022 e shqyrtoi Raportin e shkruar në fjalë, për shqiptimin e masës së vërejtjes publike.

Në pajtim me të lartpërmendurat, në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 20 dhe neni 23 paragrafi 1 alineja 1 nga LSHMAAV, në lidhje me nenin 50 paragrafi 3 i ligjit të njëjtë dhe nenit 17 nga PSHPR, pika 6 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim ndaj vendimeve të Agjencisë për të ndërmarrë masa, Raporti i shkruar për mbikëqyrjen programore me nr.ark. 10-323171 nga data 26.08.2022 dhe, nga konstatimi i shkeljes së dispozitave të LSHMAA dhe PSHPR, është përcaktuar në pikën 1 e këtij Aktvendimi. Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur më datë 16.09.2022, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht i jep vërejtje SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup dhe e obligon që në afat prej 30 (tridhjetë) ditë nga dita e pranimit të Aktvendimit që ta harmonizojë punën me dispozitat e LSHMAAV dhe PSHPR, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i theksuar në pikën 1 e këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit të shqiptuar.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër tij radiodifuzeri mund të parashtrojë padi për iniciimin e procedurës kontestimore para gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ parashtrohet në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të Aktvendimit.

Në bazë të të lartpërmendurave, u soll aktvendimi si në dispozitiv.

Shtojca (1):

1) Raporti i shkruar i mbikëqyrjes programore nr.ark.10-3261/1 nga data 26.08.2022.

**Agjencia për shërbime Mediatike  
audio dhe Audiovizuale  
Kryetar i Këshillit,  
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Këshill juridik: Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri mund të parashtrojë padi për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrative parashtrohet në 30 ditë nga dita e pranimi të aktvendimit.

**Dorëzuar deri te:**

- Shoqëria radiodifuzive tregtare KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup;
- Drejtori i Shoqërisë radifuzive tregtare KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkip;
- Personi përgjegjës i programit në Shoqërinë radiodifuzive tregtare KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup
- Sektori për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike;
- Sektori për Çështje Programore;
- Personat e emëruar të Agjencisë për udhëheqje të regjistrit

**Drejtuar: dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale**

Në bazë të nenit 28 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 42/20 dhe 77/21), dorëzohet:

**RAPORT ME SHKRIM  
PËR MBIKËQYRJEN E KRYER PROGRAMORE**

1. Lloji i mbikëqyrjes: E rregullt;
2. Subjekti i mbikëqyrjes: Shoqëria radiodifuzive tregtare KOMPANI 21-M SHPKNJP, Shkup;
3. Periudha e përfshirë me mbikëqyrjen: 5 gusht 2022;
4. Data e kryerjes së mbikëqyrjes: 26 gusht 2022;
5. Lënda e mbikëqyrjes:

- Neni 50 paragrafi 3 i Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike (mbrojtja e personave të mitur nga programe që mund ta dëmtojnë zhvillimin fizik, psikik ose moral);
- Rregullore për mbrojtje të të miturve (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 172/14);
- Nenet 53, 54, 55, 98, 99, 100 dhe 101 nga Ligji për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike (rregullat për transmetim të komunikimeve komerciale audiovizuale);
- Udhëzim për zbatim të dispozitave për plasim të produkteve (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 201/14);
- Rregullore për sponsorim (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 56/15);
- Neni 52 të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike (detyrime gjatë sigurimit të kuzeve ose formave tjera të pjesëmarrjes shpërblyese);
- Neni 93 i Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike (shfrytëzimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votim telefonik);
- Rregullore për programe me pjesëmarrje shpërblyese dhe për shfrytëzim të shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 185/14);
- Neni 94 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (transmetim të lojërave të fatit);

6. Masa e shqiptuar paraprake: /
7. Konstatime nga mbikëqyrja:

Me mbikëqyrje të rregullt programore mbi servisin programor televiziv të SHRT KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, të transmetuar më 5 gusht 2022, në nivel shtetëror, është konstatuar shkelje e nenit 50 paragrafi 3 të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike dhe nenit 17 të Rregullores për mbrojtje të të miturve.

Premierat dhe reprizat e episodeve nga të dyja seritë artistike: “Fatih Harbiye” dhe “Benim adim Melek”, telenovela me metrazh të gjatë, shumësezonale dhe njoftimet për transmetim të tyre në servisin programor nga 5 gusht 2022, u kategorizuan në mënyrë joadekuate dhe u karakterizuan si programe të kategorisë së parë të dedikuar për gjithë publikun. Duke pasur parasysh përmbajtjen e tyre edhe qasjen e regjisorit, si dhe në bazë të faktit se tashmë janë transmetuar ose ende transmetohen në servisin programor të radiodifuzerëve tjerë (me përkthim tjetër në titujt e tyre: - *Zemra e lënduar*” dhe “Lufta e nënës”) – është adekuate që seritë të klasifikohen dhe të karakterizohen si – programi i kategorisë së dytë (8+), që nuk rekomandohet për fëmijë nën moshën 8 vjeçare, për ndjekjen e të cilit rekomandohet mbikëqyrja e prindit ose kujdestarit.

5 gusht 2022

Titulli I emisionit	Periudha e transmetimit Fillimi Fundi	Përshkrimi i shkeljes
Fatih Harbiye” (“Zemra e lënduar”)	(23:25:41)	Transmetim premier dhe repriz të episodeve të serive artistike u

	<p>4 gusht</p> <p>00:00:00                      00:13:45</p> <p>12:29:50                      13:17:42</p> <p>19:53:18                      20:39:59</p>	<p>klasifikuan në mënyrë joadekuate si <u>programe të kategorisë së parë</u>. Duhet të klasifikohen dhe karakterizohen si – <u>programe të kategorisë së dytë</u>,</p>
<p>Benim adim Melek”  (“Lufta e nënës”)</p>	<p>13:17:52                      14:06:20</p> <p>20:44:17                      21:23:40</p>	<p>e përkrahshme për fëmijë nën moshën 8 vjeçare, rekomandohet për mbikëqyrje të prindit/kujdestarit.</p>

5 gusht 2022

Titulli I emisionit	Periudha e transmetimit		Përshkrimi i shkeljes
	Fillimi	Fundi	
Fatih Harbiye” (“Zemra e lënduar”)	14:58:04 16:57:07 19:05:52	14:59:38 16:58:41 19:07:27	Njoftime promovues për transmetim të serive artistike u karakterizuan në mënyrë
Benim adim Melek” (“Lufta e nënës”)	16:58:42 19:08:05	16:59:58 19:09:23	joadekuate si sinjalizim paralajmërues për <u>–program të kategorisë së parë,</u> karakteristikë adekuate e ka për <u>programin e kategorisë së dytë,</u> e parekomandueshme për fëmijë nën moshën 8 vjeçare, me rekomandim për mbikëqyrje të prindit/kujdestarit.

Përshkrimi i shkeljes:

Në kundërshtim me nenin 50 paragrafi 3 i Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike dhe nenin 17 të Rregullores për mbrojtje të të miturve në servis programor televiziv të SHRT KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, më 5 gusht 2022, transmetimi premier dhe repriz i episodeve nga seritë: “Fatih Harbiye” dhe “Benim adim Melek”, si dhe njoftimet promovues për transmetimin e tyre, u klasifikuan dhe u karakterizuan në mënyrë joadekuate të kategorisë së parë, në vend si program i kategorisë së dytë, që nuk rekomandohet për fëmijë nën moshën 8 vjeçare, përkatësisht për të cilën rekomandohet mbikëqyrje e prindit ose kujdestarit.

Propozimi i masës:

Këshilli i Agjencisë të miratojë aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike të Shoqërisë radodifuzive tregtare KOMPANI 21-M SHPKNJP, dhe në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve në Agjencinë për ndërmarrje të masës nr. 01-6039/1 nga 20.10.2015, t'i imponojë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe Rregulloren për mbrojtje të të miturve; dhe

Të kryhet mbikëqyrje kontrolluese, me qëllim të konstatimit nëse subjekti i mbikëqyrjes (radiodifuzeri) ka vepruar sipas vërejtjes (në tërësi, pjesërisht ose nuk ka vepruar), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin e veçantë (aktvendim), të miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

*Sektori për punë programore*